

VENDIM
Nr. 335, datë 19.12.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 119, DATË 24.5.2022, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘IRARBA ENERGJI’ SHPK PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË PALUAJTSHME, NË FAVOR TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË SHA”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 53, pika 2, dhe nenit 113, të ligjit nr. 144/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2073/3 prot., datë 14.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 24.5.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Irarba Energji’ sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme, në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 119, datë 24.5.2022, vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme, në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., me kusht që, brenda 3 muajve nga ky miratim, të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me bankën për këtë transferim të aseteve, përfshirë dhe listën e aseteve të paluajtshme, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre.

2. Mosdepozitimi i dokumentacionit, sipas përcaktimeve të pikës 1, e bën këtë miratim të pavlefshëm.

3. Dhënia e miratimit nga ERE për transferimin e aseteve nuk e çliron shoqërinë “Irarba Energji” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e organeve të tjera, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në çdo kohë nga ERE.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e sipërcituar me shkresën nr. 194//5 prot., datë 30.5.2022.

- Brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 119/2022, shoqëria “Irarba Energji” sh.p.k. ka depozituar në ERE kontratat/marrëveshjet barrësuese përkatëse të nënshkruara me “Bankën e Bashkuar të Shqipërisë” sh.a., por në to është përcaktuar vetëm vlera totale e aseteve dhe nuk është dokumentuar lista e detajuar e aseteve të paluajtshme, ku të përcaktohet vlera e secilit prej tyre.

- Duke marrë në konsideratë faktin që shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 119/2022, vlerësohet që t’i lihet detyrë, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi të depozitojë në ERE informacion/dokumentacionin përkatës mbi listën e detajuar të aseteve të paluajtshme, që i shërbejnë veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre, të cilat barrësohen në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar se organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. Po ashtu, në nenin 113 të KPA-së është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti administrativ, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 119, datë 24.5.2022, ndryshon si vijon:

“1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme, në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., me kusht që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimit, të depozitojë në ERE informacion/dokumentacionin përkatës mbi listën e detajuar të aseteve të paluajtshme, që i shërbejnë veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre, të cilat barrësohen në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti